KËRKESË
Nr. 30/6, datë 16.2.2023

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësim shpall kërkesën për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 125, datë 3.3.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rehabilitimi i lumit Gjanicë", "Rikonceptimi i qendrës së qytetit" dhe "Ndërtimi i Stadiumit të Lojërave me Dorë".

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Fier.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, për pasuritë e llojit "truall" bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë".

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken, por nuk figurojnë në listë, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, në Bashkinë Fier, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësim.

Efekti financiar shtesë mbi VKM-në nr. 125, datë 3.3.2021, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rehabilitimi i lumit Gjanicë", "Rikonceptimi i qendrës së qytetit" dhe "Ndërtimi i Stadiumit të Lojërave me Dorë", është 7,939,105 (shtatë milionë e nëntëqind e tridhjetë e nëntë mijë e njëqind e pesë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
KRYETAR I KOMISIONIT TË POSAÇËM
TË SHPRONËSIMEVE
Egra Ibrahimi

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN "PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 125, DATË 3.3.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "REHABILITIMI I LUMIT GJANICË", "RIKONCEPTIMI I QENDRËS SË QYTETIT" DHE "NDËRTIMI I STADIUMIT TË LOJËRAVE ME DORË"

Nr.	Nr. rendor në VKM nr. 125, DATË 3.3.2021	EMËR ATËSIA MBIEMËR	Zona kadastrale	Nr. pasurie	Sip. e objektit të banimit (m^2)	Sip. e truallit (m^2)	Sip. e objektit të shërbimit (m^2)	Çmimi objektit të banimit (l/m^2)	Çmimi i truallit (l/m^2)	Vlera e objektit të shërbimit sipas situacionit (lekë)	Vlera e objektit të banimit (lekë)	Vlera e truallit (lekë)	VLERA totale e truallit, objektit të banimit dhe shërbimit (lekë)	KOMENTE
	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14
1	16	Sami Bajram Kanaj	8531	11/18	260	445.7		52,062	12458		13,536,060	5,552,531	19,088,591	Kjo pasuri është pasqyruar në tabelën e shpronësimit bashkëngjitur VKM nr. 125, datë 3.3.2021 me nr. rendor 16 me vlerë 17,298,376 lekë
2	17	Kadri Bajram Kanaj	8531	11/318	252.8	314.1		52,062	12458		13,161,215	3,913,058	17,074,273	Kjo pasuri është pasqyruar në tabelën e shpronësimit bashkëngjitur VKM nr. 125, datë 3.3.2021 me nr. rendor 17. me vlerë 15,406,147 lekë
3	18	Fatmir Faslli Mylka	8531	11/122ND+11/122	120	380		52,062	12458		6,247,412	4,734,040	10,981,452	Kjo pasuri është pasqyruar në tabelën e shpronësimit bashkëngjitur VKM nr. 125, datë 3.3.2021 me nr. rendor 18 me vlerë 6,247,412 lekë. Mbështetur në informacionin e dërguar nga ASHK Fier, me shkresën e datës 7.2.2022, protokolluar në Bashkinë Fier me nr. 1305, datë 15.2.2022, kjo pasuri është e llojit ""TRUALL" dhe është certifikuar me sipërfaqe 500 m^2, data e lëshimit të certifikatës 16.2.2021
4	21	Ferik Idriz Shabanaj, Bele Imer Shabanaj	8531	11/37+1-1	52.56	18.94		52,062	12458		2,736,367	235,955	2,972,321	Kjo pasuri është pasqyruar në tabelën e shpronësimit bashkëngjitur VKM nr. 125 datë 3.3.2021 me nr. rendor 21 me vlerë 2,736,367 lekë.
5	22	Arben Refat Laze, Fatbardha Suri Laze	8531	11/37+1-2	61.02	18.9		52,062	12458		3,176,809	235,456	3,412,265	Kjo pasuri është pasqyruar në tabelën e shpronësimit bashkëngjitur VKM nr. 125 datë 3.3.2021 me nr. rendor 22 me vlerë 3,901,509
SHUMA TOTALE													**53,528,903**	

Vlerësimi i objekteve të banimit është bërë me çmimin mesatar të shitblerjeve për tre muajt e fundit, referuar shkresës nr. 8732/3 prot, datë 28.10.2020, të Agjencisë Shtetërorë të Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier. Vlerësimi i tokës truall është llogaritur bazuar në VKM nr. 89, datë 3.2.2016, *"Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë*".

Efekti financiar shtese ne VKM nr. 125, datë 3.3.2021 është 7,939,105 lekë.